

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues Afrim Shala, me sekretaren juridike Vahide Dërmaku, në çështjen penale ndaj të pandehurit K. TH., nga fshati R., Komuna e K., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK),¹ të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati K. S. nga Gj., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.19/2014, e datës 21.01.2014, të cilën e përfaqësonte prokurori Arben Kadriu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 05.01.2015, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri K. TH., nga babai Sh. dhe e nëna K., e lindur K., i lindur më ..., në Gj., ndërsa jeton në fshatin R., Komuna e K., shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion shofer i ... në Kompaninë "...", i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër tjetër penale,

ËSHTË FAJTOR

Në kohën e pavërtetuar më parë, pa autorizim dhe pa leje valide, ka mbajtur në pronësi armën e zjarrit dhe atë: ... revole "...", e kalibrit ... mm, me numër serik ..., prodhim "Rus", ... fishekë të kalibrit ... mm dhe ... karikatorë, e të cilët armë, me datën ...2013, rreth orës ..., e kishte përdorur në fushë, në periferi të fshatit R., Komuna e K., duke shtënë tre herë në drejtim të një qeni endacak, i cili paraprakisht ia kishte sulmuar pulat në oborr dhe më pas kishte ardhur një patrullë policore ku të njëjtën armë ia sekuestron,

- me këtë ka kryer vepër penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK.

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Andaj, kryetari i trupit gjykues, në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 46, 68, 73 dhe 74 të KPRK, si dhe nenit 233 paragrafi 21, nenit 247 dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale,² të pandehurit K. TH. i shqipton :

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit K. TH., i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 300 € (treqind Euro), të cilin dënim i pandehuri do ta paguajë në afat prej 2 (dy) muajve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që 1 (një) ditë burgim do të barazohet me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të pandehurit, në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, ta zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, ashtu që 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme do të llogariten me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë.

Krahas dënimit kryesor, ndaj të pandehurit shqiptohet edhe dënimi plotësues marrja – konfiskimi i armës Revole “...” të kalibrit ... mm me numër serik ... prodhim “Rus”, si dhe ...fishekë të kalibrit ... mm dhe ... karikator.

Detyrohet i pandehuri që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 30 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

ARSYETIMI

1. Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, më 21.01.2014 ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit K. TH., nga fshati R., Komuna e K., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK.

Së bashku me këtë aktakuzë, është dorëzuar edhe një marrëveshje për pranimin e fajësisë e lidhur në mes të Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, në njërën anë dhe të pandehurit K. TH. dhe mbrojtësit të tij, avokatit K. S.nga Gj., në anën tjetër. Sipas kësaj marrëveshje,

² Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejshme KPP), nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

kësaj Gjykate, i është rekomanduar që ndaj të pandehurit K. TH., për shkak të kryerjes së veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, t'i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 300€ (treqind Euro).

2. Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datën 05.01.2015, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit të të pandehurit, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pas konsultimeve të mjaftueshme, me mbrojtësin e tij, avokatin K. S.; se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanta e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, kryetari i trupit gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i pandehuri K. TH., me dashje e ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 374 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se formën themelore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, e kryen “kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, për të cilën është parashikuar dënim me gjobë deri në 7.500 € (shtatë mijë e pesëqind Euro) ose me burgim deri në 5 (pesë) vjet”. Ndërsa, duke u bazuar në nenet 17 deri 21 të Ligjit për armët,³ është parashikuar se për të mbajtur në posedim apo pronësi ndonjë

³ Ligji nr.03/L-143 për Armët, i datës 17.09.2009.

armë,⁴ duhet që personi të ketë leje valide të lëshuar nga organi kompetent. Duke u bazuar në këto dispozita ligjore, kryetari i trupit gjykues, e ka shpallur fajtor të pandehurin K. TH., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, ngase veprimet e të njejtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njejtën është edhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se i njejtë, siç e ka pranuar edhe vetë, në kohën e pavërtetuar më parë, pa autorizim dhe pa leje valide, ka mbajtur në pronësi armën e zjarrit dhe atë: një Revole "...", e kalibrit ... mm, me numër serik ..., prodhim Rus, ... fishek të kalibrit ... mm dhe ... karikatorë, e të cilët armë, me datën2013, rreth orës ..., e kishte përdorur në fushë, në periferi të fshatit R., Komuna e K., duke shtënë tre herë në drejtim të një qeni endacak, i cili paraprakisht ia kishte sulmuar pulat në oborr, dhe më pas kishte ardhur një patrullë policore ku të njejtën armë ia sekuestron.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Kryetari i trupit gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se duhet të aprovohet rekomandimi i paraqitur në marrëveshjen për pranimin e fajësisë që ndaj të pandehurit K. TH., të shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 300 € (treqind Euro), ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit, kryetari i trupit gjykues i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenet 73 deri 76 të KPRK. Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës kryetari i trupit gjykues e ka shqiptuar dënimin, është fakti se i pandehuri ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Themelore në Gjiilan, Departamenti i Krimeve të Rënda. Gjithashtu, si rrethana posaçërisht lehtësuese, kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë edhe faktin se i pandehuri ka bashkëpunuar me prokurorin e shtetit; se pranimin e fajësisë e ka bërë gjatë të gjitha fazave të procedurës penale; se i pandehuri është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale; se i njejtë ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale; se sipas deklaratës së të pandehurit, të cilës kryetari i trupit gjykues ja fali besimin, i njejtë është i martuar dhe është baba i dy fëmijëve, si dhe fakti se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale me vendim të formës së prerë. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i pandehuri me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale.

⁴ Duke u bazuar në nenin 120 paragrafi 38 të KPRK, shprehja "armë", përveç tjerash, përfshinë edhe municionin, pjesët e armëve dhe përbërësit e armëve.

Ndërsa, kryetari i trupit gjykues, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese në këtë çështje penale.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së kryetarit të trupit gjykues, dënimi me gjobë në shumë prej 300 € (treqind Euro) ndaj të pandehurit K. TH., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Përveç këtyre, me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë edhe gjendjen pasurore të të pandehurit dhe faktin se i njëjti është shofer i ... në kompaninë “...”.

Kryetari i trupit gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Zëvendësimi i dënimit me gjobë

Kryetari i trupit gjykues duke u bazuar në nenin 46 të KPRK, ka vendosur që nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të barazohet me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të pandehurit, në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, ta zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, ashtu që 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme do të llogariten me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë.

8. Dënimi plotësues

Duke u bazuar në nenin 69 paragrafi 1 të KPRK, kryetari i trupit gjykues, krahas dënimit kryesor, ndaj të pandehurit ka vendosur që të shqiptojë edhe dënimin plotësues marrja – konfiskimi i armës Revole “...” të kalibrit ... mm me numër serik ... prodhim “Rus”, si dhe ... fishek të kalibrit ... mm dhe ... karikator.

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të akuzuarve, kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar nenin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar vetëm paushallin gjyqësor në shumë prej 30 Euro.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Krimeve të Rënda

Më 05.01.2015

Sekretarja juridike,
Vahide Dermaku

Kryetari i trupit gjykues,
Afrim Shala

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi nuk mund të paraqitet ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, e as për shkak të vendimit për dënimin.